



FTESË PUBLIKE

Të nderuara biznese, individë dhe organizata joqeveritare

Komuna e Klinës – Drejtoria për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural, në kuadër të Festivalit Folklorik “I këndojmë lirisë” edhe këtë vit organizon Panairin e Produkteve Vendore që do të mbahet me datat 6,7, dhe 8 qershor 2023 në Sheshin “Mujë Krasniqi” në Klinë, festivali dhe panairi organizohen në përkujdesjen e kryetarit të komunës së Klinës Prof.Dr. Zenun Elezaj.

Panairi ka për qëllim të bëhet tradicional sepse po organizohet për disa vite radhazi dhe po ekspozon biznese me produkte të ndryshme të tyre, artizanale e prodhime vendore si dhe nga vizitorë të shumtë është shprehur interes dhe pëlqim i madh. Gjithashtu qëllimi ynë, duke ju ofruar hapsirë dhe mundësi promovimi është që t’i mbështesim këto biznese, ndërmarrjet e vogla dhe të mesme si dhe individë që krijojnë produkte të tilla.

Panairi parasheh promovimin e rreth 40 bizneseve, duka ofruar hapsirë të përshtatshme, me tenda dhe tavolina pune dhe orar të përshtatshëm paralel me zhvillimin e festivalit folklorik, që rritë numrin e vizitorëve dhe mundësinë e mbështetjes me të madhe ndaj prodhuesve vendor.

Hapja solemne e panairit bëhet me datë 6 qershor 2023, dhe zgjat tri ditë.

Formularin për aplikim e gjeni në web-faqen e komunës së Klinës, të cilin pas plotësimit mund ta sillni fizikisht në BPZHR apo ta dërgoni përmes email-it: Lorenc.marleku@rks-gov.net

Afati për aplikim është nga data 08.05.2023 deri më datën 30.05.2023

Pjesëmarrja juaj na nderon!



Me respekt; Drejtori i BPZHR-së
Lorenc Marleku